

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" SAS BAKERY " SHPK

Sot me daten 27/09/2022 (dymijë e njëzet e dy), ne ortakët themelues :

- **1. Z. Ardian Kazazi**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 25 Prill 1965, lindur në Shqipëri dhe banues në Durrës, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. G50425093F
- **2. Znj.Stela Meta**, shtetase shqiptare, i datëlindjes 07 Mars 1980, lindur në Shqipëri dhe banues në Durrës, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. I05307085U

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit",

Kam vendosur të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar " SAS BAKERY" SHPK.

NENI 1.
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet " SAS BAKERY" SHPK.


NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Lagjja 16, Rruga Mbreti Gert, Zona Kadastrale 8513, Pallati Nr. 2, Kati I-re,Durrës.

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj ne fushen e : Përpunimin, prodhimin dhe tregtimin e produkteve të brumit (briosh, bombolone, etj) me pakicë e shumicë. Import, eksport. Agjensi imobiliare. Bar, restorant, hoteleri. Tregtim e prodhim të mallrave të të gjitha llojeve, industriale e ushqimore, import, ekportin e tyre. Ndërtime civile. Prodhime buke dhe te pasticerise te te gjitha llojeve.

NENI 4
KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË



Kapitali themeltar i shoqërisë "SAS BAKERY" SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 2 kuota, me vlerë nominale 50.000 (njëqind mijë) lekë.

Kontributi i ortakëve është i ndare si vijon:

- 1. Ardian Kazazi zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.**
- 2. Stela Meta zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.**

NENI 5 **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

NENI 6 **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. STELA META**, e cila emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marredhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 7 **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 8 **NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.



Neni 9
LIKUIDIMI

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

NENI 10
MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË
" SAS BAKERY" SH.P.K

ARDIAN KAZAZI



STELA META

